

AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Prime Tech” Sh.p.k

Bazuar në vullnetin e ortakut themelues dhe mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, vendoset si më poshtë:

KREU I:
Themelimi, Emërtimi, Objekti, Selia dhe Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 1
Themelimi, Themeluesit, Emërtimi

Sot, më datë 05.01.2026 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin: **“Prime Tech” Sh.p.k.**

Themeluesi i shoqërisë **“Prime Tech” Sh.p.k** është **Z. Luan Boçi**, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 05.12.1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 034288758 dhe nr. personal H21205044K, i cili hartoi këtë Akt - Themelimi në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: “Veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit, krijimin dhe menaxhimin e sistemeve database, krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dixhitale”.

Neni 3
Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Nd. 18, H. 5, Ap. 35, Njësia Administrative Nr. 5, 1022, Tiranë.

Neni 4
Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar. Ky afat mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet në rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që pasqyrohen në statut.



KREU II:
Kapitali i shoqërisë
Neni 5
Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë.

Lloji i kontributit është në para dhe përbëhet nga 1 kuotë si më poshtë:

Z. Luan Boçi, është zotërues i 1 (një) Kuote, qe i korrespondon 100 % (njëqind përqind) të Kapitalit të Shoqërisë dhe vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) Lekë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakut i shoqërisë.

KREU III:
Administratori i shoqërisë

Neni 6
Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit

6.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të administrohet nga një Administrator i vetëm.

6.2 Administratori i shoqërisë emërohet me vendim të ortakut të shoqërisë. Afati i qëndrimit në detyrë të administratorit të shoqërisë është për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

6.3 Administrator i kësaj shoqërie për një periudhë 5 (pesë) vjeçare caktohet **Z. Luan Boçi**, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 05.12.1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 034288758 dhe nr. personal H21205044K.

KREU IV:
Dispozitat Përfundimtare
Neni 7

7.1 Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimtarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë pune sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.

7.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut të vetëm, administratorit dhe personave të tjerë të punësuar në Shoqëri, në rast se nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

7.3 Shoqëria do të ketë vulën e saj, e cila do të përmbajë mbishkrimin “Prime Tech” Sh.p.k dhe NIPT-in e shoqërisë.



7.4 Modalitet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblese së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

7.5 Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e aktit të themelimit së bashku me statutin e shoqërisë, depozitohen nga Administratori i saj Z. Luan Boçi dhe ruhen në QKB (Qendrën Kombëtare e Biznesit).

Ky akt themelimi u redaktua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

Tiranë, më datë 05/01/2026

ORTAKU THEMELUES

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Prime Tech” Sh.p.k

Z. Luan BOÇI

Luan Boçi 